



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201601666/5

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** *Rekomandim për zgjidhjen konform akteve normative në fuqi të rastit të bllokimit të armës së gjahut shtetasit F.A.*

**Drejtuar :** Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë  
Z. Alfred ÇEPE

Elbasan

*I nderuar zoti Çepe,*

Sikurse ju kemi vënë në dijeni, në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi F.A. me banim në fshatin Zgosht, Njësia Administrative Lunik, Bashkia Librazhd. Ankuesi shkruan se në vitin 2014 shtetasi A.A. ka bllokuar rrugëkalimin për shkak të ndërtimit të një rezervuari për vaditjen e kulturave bujqësore. Përfaqësuesi i Komunës Lunik së bashku me punonjës të policisë së zonës kanë shkuar në vendin e bllokimit të rrugës dhe kanë bllokuar punimet që bënte shtetasi A.A.. Ndërkohë punonjësi i policisë i ka thënë ankuesit që të shkonte në Komisaratin e Policisë Librazhd dhe të dorëzonte armën e gjahut të cilën e kishte me leje. Ankuesi ka shkuar në komisaratin dhe ka dorëzuar armën e gjahut. Aty është mbajtur një procesverbal në të cilin u pasqyrua fakti se, arma do të dorëzohej pas zgjidhjes së konfliktit ndërmjet tyre.

Meqënëse problemi i hapjes së rrugëkalimit nuk u zgjidh nga strukturat vendore, ankuesi ka bërë ankesë në INUK Tiranë. Me ndërhyrjen e INUK-ut, Bashkia Librazhd ka bërë të mundur zgjidhjen e këtij problemi duke liruar rrugën publike.

Pas lirim të rrugëkalimit, ankuesi ka shkuar në Komisaratin e Policisë Librazhd dhe ka kërkuar që ti kthehet arma e gjahut e bllokuar para dy vitesh. Nga përfaqësuesit e këtij komisarati i është thënë verbalisht se armën do ta merrte pasi të merrte më parë një deklaratë me shkrim nga shtetasi A.A., ku ky i fundit të deklaronte se nuk ka konflikte me ankuesin. Këtë kërkesë të policisë ai e konsideron të padrejtë, sepse konflikti që patën për problemin e bllokimit të rrugës nga shtetasi A.A. u zgjidh nga organet shtetërore dhe jo me vetëgjyqësi.

Ndodhur në këto rrethana ankuesi i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan për zgjidhjen e këtij problemi, kthimin e armës së

gjahut. Mirëpo ai pretendon se problemi nuk i është zgjidhur ende dhe atij nuk i është kthyer as përgjigje e kërkesës së bërë.

Në bazë të kërkesës tonë, ju me shkresën nr. 6404/2, datë 19.09.2016, ndërmjet të tjerave na informuat se, shtetasi F.A. disponon një armë gjahu me leje përkatëse në bazë të ligjit. N/Specialisti i policimit në komunitet ka bërë bllokimin e armës së gjahut shtetasit F.A. pasi ai ka patur konflikt të mprehtë pronësie me shtetasin A.A.. Meqënëse shtetasi F.A. dispononte armë gjahu me leje dhe duke vlerësuar që konflikti ishte i mprehtë, me qëllim parandalimin e ndonjë vepre penale është bërë bllokimi i armës së gjahut të tij deri në sqarimin e këtij konflikti dhe zgjidhjen e problemit.

Shtetasit F.A. dhe A.A. janë thirrur disa herë në komisariatit e Policisë Librazhd, ku janë ballafaquar dhe u janë marrë deklaratime të cilat vërtetojnë për vazhdimësinë e konfliktit.

Sipas jush, edhe pas dërgimit të shkresës tonë është njoftuar shtetasi F.A., por ai nuk është paraqitur dhe sipas familjarëve rezulton se ka qënë larguar për disa ditë tek të afërmit e tij. Ndërsa nga verifikimet e bërë lidhur me shtetasin A.A. rezulton se ai ndodhet jashtë shtetit në Greqi si emigrant.

Gjithashtu ju na informoni se konflikti ndërmjet tyre është trajtuar në mënyrë të vazhdueshme nga Komisariati i Policisë Librazhd dhe rezulton se ai vazhdon. Ky fakt provohet edhe nga kryepelqësia e fshatit Zgosht.

Bashkëlidhur shpjegimeve na keni dërguar edhe fotokopje të disa dokumentave që lidhen me këtë problem ndërmjet të cilave edhe procesverbalin e bllokimit të armës së gjahut ankuesit.

Nga shqyrtimi i kësaj ankesë dhe i përgjigjes së dërguar nga ana juaj arrijmë në konkluzionin se, bllokimi i armës së gjahut shtetasit F.A. është bërë nga punonjësi i policisë Faik Balla me detyrë N/Specialist i Policisë së Rendit në Komisarariatit e Policisë Librazhd në datën 03.09.2014. Mbajtja në gjëndje bllokimi i kësaj arme gjahu për një kohë prej 2 vjetësh është veprim i paligjshëm dhe vjen në kundërshtim me nenin 108/3 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit, sipas të cilit afati maksimal i bllokimit të sendeve është 90 ditë. Bllokimi i armës së gjahut për një kohë kaq të gjatë, sikurse ka ndodhur në këtë rast, nuk parashikohet as në dispozitat e akteve normative që kanë qënë në fuqi në atë kohë, ligjin nr. 99/2013, si dhe në ligjet që janë në fuqi aktualisht, nr. 74/2014 "Për armët" dhe nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", si aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatimin e tyre.

Ky veprim i policisë ka sjellë shkeljen e të drejtës ligjore të ankuesit për të poseduar e gëzuar lirisht pronën e tij të ligjshme (armën e gjahut) të garantuar nga dispozitat e Kodit Civil. Nëse shtetasi F.A. ka shkelur kriteret ligjore për mbajtjen e armës së gjahut, nga komisioni përkatës duhet të veprohej konform dispozitave ligjore që ishin në fuqi në kohën e bllokimit të armës, duke ia hequr atij lejen e dhënë për të mbajtur armën e gjahut dhe bërë shitjen e kësaj arme duke zbatuar procedurat përkatëse.

Për sa më sipër dhe me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*" dhe në gërmën "b" të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku

parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

### **REKOMANDOJMË**

1. Marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen përfundimtare dhe konform dispozitave të akteve normative në fuqi të problemit të bllokimit të armës së gjahut shtetasit F.A..

2. Zbatimin me korrektesë nga punonjësit e policisë të detyrimeve që rrjedhin nga neni 121 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, lidhur me rastet dhe afatet kohore të bllokimit të sendeve qytetarëve të ndryshëm.

3. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në efektivin e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, pavarësisht faktit që ai ka ndodhur para më shumë se dy vitesh, me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen në organet tuaja.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**